



**UNIVERSITETI**

**I SHKENCAVE TË APLIKUARA**

— FERIZAJ —

**Fakulteti i Inxhinierise dhe Informatikes**

**BËHU**

**PROFESIONIST**



[FACEBOOK.COM/USHAF.NET](https://www.facebook.com/USHAF.NET)



[INSTAGRAM.COM/USHA FERIZAJ](https://www.instagram.com/USHA FERIZAJ)



UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

**Rr. Universiteti, p.n. 70000 Ferizaj, Kosovë**  
**Tel.+381 290 310 010 | [www.ushaf.net](http://www.ushaf.net)**


## Fakulteti i inxhinierisë dhe informatikës

Në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Informatikës ofrohet programi Bachelor i studimeve në Inxhinieri Industriale me Informatikë, programi Bachelor i studimeve në Informatikë të Aplikuar dhe programi Master i studimeve në Inxhinieri dhe Menaxhimi I Prodhimit.

Programet janë të organizuara në module dhe të vlerësuara me kredi, të cilat janë në përputhje me sistemin evropian të kredive. Këto programe u ofrojnë studentëve përvetësimin e shkathtësive adekuate për fushën e tyre të profesionit që do të ushtrojnë në të ardhmen. Kjo mundësohet përmes ambienteve moderne të punës, pra laboratoreve dhe pajisjeve moderne, si dhe përmes bashkëpunimit me kompani e institucione kombëtare e ndërkombëtare.

Mendime të studentëve rreth përzgjedhjes së programit të studimeve në UShAF

Donikë Guri  
studente e programit Master  
Inxhinieri dhe Menaxhimi I Prodhimit



“Perspektiva e madhe për vende të punës në rajonin e Ferizajt, si dhe pozita gjeografike e Universitetit kanë bërë të jenë zgjedhje ideale për mua. Mundësitë e studimit semestral jashtë vendit, vizitat e shumta në kompani të ndryshme, pastaj puna praktike në to, po edhe në laboratorët e Universitetit, ofrojnë mundësi jashtëzakonisht të mëdha në avancimin tonë. Falë shumëllojshmërisë së lëndëve në këtë fakultet, ne tashmë jemi të aftë në fushën e inxhinierisë si dhe në fusha të tjera si: informatika, fizika e matematika.

**Skeno QR CODE për të  
parë video materiale**



## **Inxhinieri Industriale me Informatikë – Bachelor**

Programi trevjeçar në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, Inxhinieri Industriale me Informatikë, do t'u ofrojë studentëve standardet më të larta ndërkombëtare të mësimit teorik dhe praktik në fushën e inxhinierisë industriale duke përdorur mjete dhe aplikacione të ndryshme informatike. Ky program do ti trajton konceptet e inxhinierisë industriale përmes analizës së nevojave dhe fokusit të teknologjisë informative dhe programimit në zgjidhje e problemeve dhe / ose nevojave konkrete.

Mundësi punësimi në të ardhmen

Pas përfundimit të studimeve të tyre, të diplomuarit do të jenë në gjendje të punojnë në industrinë e mëposhtme dhe llojin e angazhimeve:

- Inxhinier i prodhimit dhe projektimit të sistemeve industriale
- Zhvillues produkti
- Zhvillues dhe dizajner i procesit
- Udhëheqës në industri të prodhimit
- Vetëpunësuar dhe sipërmarrës

## **Informatikë e Aplikuar – Bachelor**

Programi trevjeçar në Universitetin e Shkencave të Aplikuara “Informatikë e Aplikuar”, do t'u ofrojë studentëve njohuri bashkëkohore teorike dhe praktike në fushën e informatikës së aplikuar.

Këto njohuri studentëve do t'u transmetohen përmes mësimdhënies interaktive dhe hulumtimeve në Informatikën e Aplikuar, me theks të veçantë në zhvillimin e teknologjive të informacionit në zgjedhje të problemeve konkrete dhe zbatimin e tyre në Industri, kjo për të zhvilluar profesionist të kualifikuar dhe ndërmarrës të nivelit të lartë të fushës e IT-se, në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Mundësi punësimi në të ardhmen

Pas përfundimit të studimeve të tyre, të diplomuarit do të jenë në gjendje të punojnë në industrinë e mëposhtme dhe llojin e angazhimeve:

- Programer (Desktop, Ueb dhe Mobile)
- Specialistë të TI në kompani të ndryshme
- Konsulent i sistemit; Projektuesi i sistemit
- Analist i biznesit; Arkitekt i TI
- Koordinator TI; Arkitekt i sistemit
- Specialist i informatikës së biznesit; Administratorët e shërbimit TI,
- Administratorët e rrjetit kompjuterik;
- Menaxherët e projektit ose asistentët e menaxherëve të projekteve.
- Koordinatori i projektit
- Biznese vetanake ose të punojnë si lancerë të lirë.